



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:157762  
Datë: 18.10.2024  
Numri i dokumentit: 06320556

**C.nr.11/2011**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm , Divizioni Civil, me gjyqtaren Hatixhe Begaj, në çështjen juridike të paditësit N.M. nga Malisheva, të cilin e përfaqëson me autorizim av.Faik Morina nga Malisheva, kundër të paditurve H.M.dhe A.M., që të dy nga Malisheva, për shkak të mashtrimit, vlera e kontestit 3001.00, jashtë seancës, me datë 18.10.2024 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET** për shkak të vdekjes së paditësit N.Z.M.nga Malisheva.
- II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e paditësit e marrin përsipër procedurën apo kur të njëjtit i thërret gjykata që të bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

**A r s y e t i m**

Paditësi me dt.16.02.2011 ka parashtruar padi në këtë gjykatë me bazë juridike mashtrim, kundër të paditurve H.M.dhe A.M., që të dy nga Malisheva.

Kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore për datë 16.10.2024, në të cilën seancë nuk ka prezantuar i autorizuari i paditësit av.Faik Morina edhe pse i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, nuk ka prezantuar i padituri H.M.ku shërbimi i postës ka deklaruar se ky person gjendet në F. –ka deklaruar prindi, ka prezantuar i paditurit A.M., ndërsa për paditësin është paraqitur vajza e tij E.C., e cila ka njoftuar gjykatën se prindi im nuk është më në jetë dhe lidhur me këtë çështje palët janë marrë vesh shumë kohë më parë para 6 viteve, po ashtu edhe i padituri ka deklaruar se kjo çështje ka përfunduar shumë kohë më parë.

Për të vërtetuar faktin se paditësi ka vdekur gjykata i është drejtuar me kërkesë zyrtare Zyrës së Gjendjes Civile pas mbajtjes së seancës, për ta njoftuar gjykatën lidhur me këtë fakt dhe eventualisht në rast të konfirmimit të tij të dërgojnë certifikatën e vdekjes për paditësin.

Ku sipas kërkesës edhe është siguruar certifikata e vdekjes për paditësin N.M. me numër rendor 5 dhe nr.ref..... dhe nr.ser. V ... e dt.16.10.2024 nga e cila gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.Z.M.ka vdekur me datë 03.02.2024.

Gjykata bazuar në të lartcekurat e posaçërisht në certifikatën e vdekjes së lart cituar , mbështetur në dispozitat ligjore të LPK-së përkatësisht nenin 277 pika (a) ku thuhet; Procesi gjyqësor

ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim; vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil  
C.nr.11/2011, me dt.18.10.2024

Gjyqtarja  
Hatixhe Begaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.